

Thirrje për Publikime

**Konferenca e 2-të
Ndërkombëtare mbi
ARTET DHE
EDUKIMIN**

**“Krijimtaria, Trashëgimia & Edukimi Artistik
në Kohën e Teknologjisë”**

11-12 Qershor 2026

Universiteti i Arteve
Tiranë, Shqipëri

Afati i fundit për
dorëzimi e abstraktit
dhe punimit të plotë:

28 Shkurt 2026

Afati i fundit për
njoftimin e pranimit
të punimit:

30 Prill 2026

Afati i fundit i pagesës:

30 Maj 2026

Regjistrimi i pjesëmarrësve:

11 Qershor 2026

ICAE-2026

Konferenca e 2-të Ndërkombëtare mbi Artet dhe Edukimin

“Krijimtaria, Trashëgimia & Edukimi Artistik në Kohën e Teknologjisë”

11-12 Qershor 2026

Thirrje për Punime Shkencore

Konferenca e 2-të Ndërkombëtare mbi Artet dhe Edukimin, Konferenca ICAE - 2026, “Krijimtaria, Trashëgimia dhe Edukimi Artistik në Kohën e Teknologjisë” synon të sjellë së bashku studiues, artistë, edukatorë, profesionistë të kulturës dhe ekspertë të teknologjisë për të kontribuar me kërkime, qasje praktike dhe diskutime teorike. Konferenca Ndërdisciplinore e Universitetit të Arteve për vitin 2026 synon të krijojë një hapësirë të gjerë dialogu, kërkimi dhe reflektimi mbi zhvillimet bashkëkohore në fushat e artit pamor, artit skenik dhe kinematografisë, muzikës, edukimit artistik dhe trashëgimisë kulturore. Duke u mbështetur në traditën akademike të institucionit dhe në angazhimin e tij për qasje të reja dhe inovacion, kjo konferencë ndërthur perspektiva teorike, praktika krijuese dhe qasje kërkimore dhe artistike, duke nxitur bashkëpunime ndërmjet studiuesve, artistëve dhe profesionistëve të fushave të ndryshme.

Tematikat e Konferencës (jo kufizuese)

Në artet pamore, konferenca synon të eksplorojë mënyrën se si arti reagon ndaj realiteteve sociale, teknologjike dhe kulturore, si dhe transformimet e estetikës në epokën digjitale, roli i imazhit, format e reja të shprehjes vizuale dhe sfidat e krijuesit bashkëkohor.

- 1. Arti digjital (AI, VR, AR).**
- 2. Estetika post-mediale.**
- 3. Arti si kritikë sociale/politike.**
- 4. Pikturë, skulpturë, instalacion bashkëkohor.**
- 5. Arti në hapësirë publike.**
- 6. Ekologjia vizuale dhe qëndrueshmëria.**

Në fushën e arteve skenike dhe kinematografisë, konferenca vendos theksin te proceset krijuese, roli i gjuhës së trupit, performanca, si dhe qasjet e reja kinematografike që lindin nga teknologjitë emergjente dhe format hibride të rrëfimit.

- 1. Performanca dhe roli i gjuhës së trupit në skenë.**
- 2. Dramaturgjia dhe skenografia moderne.**
- 3. Kinemaja shqiptare/rajonale sot.**
- 4. Teknologjitë digjitale në teatër/film.**
- 5. Tregime hibride: dokumentar–fikson–eksperiment.**
- 6. Interpretimi i teatrit klasik.**

Muzika, si një gjuhë universale, trajtohet në ndërthurje me kërkimin akademik, interpretimin dhe kompozimin, duke hapur diskutime për identitetin muzikor, eksperimentimin dhe ndikimin e kulturave të ndryshme në krijimtarinë bashkëkohore.

1. Tradita muzikore dhe moderniteti në krijim.
2. Kompozicioni dhe muzika shqiptare bashkëkohore.
3. Analiza dhe qasjet ndërdisiplinore.
4. Muzika dhe teknologjia.
5. Muzika si identitet kulturor.
6. Interpretimi si kërkim dhe veçoritë e tij.

Në fushën e edukimit, konferenca adreson rolin e edukimit artistik në formimin e individit, metodat pedagogjike inovative dhe sfidat e arsimit në një shoqëri që ndryshon me ritme të shpejta.

1. Metodatat bashkëkohore të mësimdhënies.
2. Teknologjia në edukimin artistik.
3. Edukimi estetik dhe kreativiteti.
4. Praktika pedagogjike ndërdisiplinore në artet e ndryshme.
5. Kompetencat kulturore/sociale përmes artit.
6. Formimi i mësuesit të arteve.

Në fushën e Trashëgimisë Kulturore trajtohet si një urë mes së shkuarës dhe së tashmes, duke shqyrtuar mënyrat e ruajtjes, interpretimit dhe riaktualizimit të saj në kontekstin modern.

1. Ruajtja dhe restaurimi.
2. Dokumentimi me teknologji.
3. Interpretimi bashkëkohor i trashëgimisë.
4. Turizmi kulturor.
5. Trashëgimia dhe identiteti.
6. Ndërthurja e artit të sotëm me traditën.

Për të pasuruar diskutimet dhe kërkimin, konferenca mirëpret gjithashtu kontribute mbi:

1. Qëndrueshmëria në Arte.
2. Angazhimi i Komunitetit në Art.
3. Arti dhe Shëndeti Mendor.
4. Globalizimi dhe Identiteti Lokal.
5. Arti në Hapësirat Publike.
6. Sipërmarrja në Arte.
7. Artet dhe Teknologjia.
8. Gratë në Arte.
9. Kritika dhe Analiza e Arteve.

Udhëzime të përgjithshme

Autorët e konferencës duhet të dorëzojnë një punim maksimumi 12 faqe ku përfshihen figura, tabela, shembuj muzikorë dhe referenca. Punimet duhet të përgatiten në formatin Word, **(shkarkoni formatin nga faqja e internetit e ICAE)** dhe të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën **conference@uart.edu.al**. Të gjitha punimet e pranuar të konferencës do të publikohen në E-Proceedings Book me numër ISBN.

Gjuhët zyrtare të Konferencës

Shqip, Anglisht

Mënyrat e prezantimit

- Prezantim fizik në sallë
- Prezantim online

Data të Rëndësishme

Afati i fundit i dorëzimit të abstraktit dhe punimit të plotë: **28 Shkurt 2026**

Afati i fundit për njoftimin e pranimit të punimit: **30 Prill 2026**

Afati i fundit i pagesës: **30 Maj 2026**

Regjistrimi i Pjesëmarrësve: **11 Qershor 2026**

Datat e Konferencës: **11-12 Qershor 2026**

Kontakt

Email: **conference@uart.edu.al**

Regjistrimi

Pas aprovimit, ju do të merrni një E-mail konfirmimi me numrin tuaj të regjistrimit, detajet e bankës dhe informacione të tjera.

Tarifa e konferencës për çdo punim të pranuar: 50 euro / 5000 ALL

UDHËZUES PËR AUTORËT

HAPAT QË DUHET TË NDIQEN PËR PARAQITJEN E ARTIKULLIT

- 1. Gjuha e dokumentit:** Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe dhe angleze.
- 2. Punimi i plotë** duhet të përmbajë rreth **2500-3000 fjalë** dhe të jetë maksimumi deri në 12 faqe ku përfshihen edhe shembujt muzikorë, tabelat, figura, foto, referenca etj.)
3. Abstrakti duhet të jetë i shkurtër, të tregojë qëllimin/rëndësinë e hulumtimit, metodologjinë, rezultate apo gjetje të punimit, përfundime dhe rekomandimet. Abstrakti duhet të përmbajë **rreth 250-300 fjalë dhe fjalët kyçe 3 deri në 5 fjalë**. Abstrakti duhet të jetë **një paragraf i vetëm** dhe duhet të ndjekë stilin e abstrakteve të strukturuar. Lutemi, të mos përdoren **simbole, karaktere të veçanta apo shënime në fund të faqes** në titullin e punimit dhe në abstrakt.
- 4. Specifikat e formatit:**
Titulli i artikullit: Times New Roman, sentence case, font size 14, bold, centered.
Emri i autorit: ¹First Author, A. A.; ²Second Author, B. B.; ³Third Author, C. C., etc.
Përfshirë: adresat e emailit të të gjithë autorëve, përkatësia e autorit/autorëve (Institucioni, Shteti)
Formatimi: Times New Roman, size 12, centred paragraph.
Përmbajtja:
 - Teksti i Abstraktit duhet të përmbajë deri në 250 -300 fjalë
 - Shkrimi Times New Roman 12, Normal
 - Paragrafët duhet të jenë Justified (straight-edged)
 - Hapësira ndërmjet rreshtave 1.5
 - Page Margins duhet të jenë 2,5 cm në të katër anët**Abstrakti duhet të përfshijë** qëllimin/rëndësinë e hulumtimit, metodologjinë, rezultate apo gjetje të punimi, përfundime dhe rekomandimet. Abstraktet që nuk plotësojnë këto kërkesa të formatimit nuk do të pranohen dhe do të kthehen.
Fjalë kyçe [Majtas, Times New Roman, Font size 12, Bold, italics]: Shkruani 3 deri në 5 terma/fjalë kyçe që nuk përmenden në titullin e punimit, të ndara me presje (.).
- 5. Struktura duhet të jetë si më poshtë:**
 - Abstrakti;
 - Hyrja;
 - Rishikimi i literaturës;
 - Metodologjia;
 - Rezultate dhe diskutime;
 - Përfundime dhe rekomandime;
 - Referenca;
 - Shtojca (nëse ka)

Punimi duhet të dorëzohet në formatin **Microsoft Word (97-2003 document)** me cilësimet e mëposhtme:

 - Punimi duhet të ketë **deri në 15 referenca**.**Stili i të shkruarit do të jetë si më poshtë:**
 - Font: Times New Roman
 - Font Size: 12
 - Line Spacing: 1.5
 - Paper size A4**Citimi dhe referimi në tekst:** stili i referimit **Chicago Style**.
Citimet në fund të faqes duhet të jenë:
 - Font Size: 10
 - Font: Times New Roman
 - Numri i faqeve duhet të vendoset në këndin e poshtëm djathtas të faqes.

Abstrakti dhe punimi i plotë në shqip dhe anglisht duhet të dërgohen në adresën e emailit **conference@uart.edu.al** duke specifikuar gjithashtu fushën e përzgjedhur.
6. Të gjitha abstraktet dhe punimet do t'i nënshtrohen **peer review**.
7. Çdo punim duhet të plotësojë standardet e kërkuara akademike.
8. Autorët do të njoftohen me e-mail, duke përdorur adresën e deklaruar. Ata që nuk marrin konfirmimin brenda datës së caktuar, duhet të kontaktojnë në adresën e emailit **conference@uart.edu.al**.
9. Prezantimi në konferencë mund të bëhet **fizikisht ose online**.